



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

27 Nëntor 2020

1. a) **Komuna e Gjakovës**, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, Ardian Gjini, në tekstin vijues theksohet Komuna.
- b) **N.P. Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë SH.A.**, të cilën e përfaqëson U.D Kryeshefja Ekzekutive Albana Skivjani në tekstin vijues “**Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë**” në njërën anë; dhe
2. **Kompania Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A.**, të cilën (në këtë çështje) e përfaqëson Drejtori për investime Hasan OZ, në tekstin vijues KEDS

Neni 1

Qëllimi i Memomarendumit të Mirëkuptimit

- 1.1 Qëllimi i këtij **Memorandumi të Mirëkuptimit** është bashkëpunimi në implementimin dhe zbatimin e projektit për ndërtimin-instalimin e kabullit nëntokësor LP 10 (20) kV nga NS 110/10 kV “Gjakova 2” deri te lokacioni i implementimit të kogjenerimit me biomasë për Ngrohtoren e Re në Gjakovë. Kjo linjë e re 10/20 kV që është paraparë të ndërtohet përkaj rrugës së re transit (e cila rrugë gjithashtu pritët të ndërtohet në vitet e ardhshme) në disa segmente të saj nuk mund të implementohet sipas Pëlqimeve Elektroenergetike nr. 5609 të datës 24.07.2020 (si konsumatorë) dhe nr. 9556 dt. 24.11.2020 (si gjeneratorë) të lëshuar nga KEDS, para se të përfundohet rruga transit. Përmes këtij MiM është planifikuar që linja 10/20 kV të ndërtohet përkaj kësaj rruge, ndërsa në segmentet e rrugës ku nuk plotësohen standardet minimale (për shkak të dallimeve të mëdha të niveleve aktuale të terrenit dhe nivelit të planifikuar të rrugës) të anashkalohet zgjidhja teknike e KEDS dhe linja e re nëntokësore të vendoset sipas nivelit aktual të terrenit në kohë të përkohshme. Pas përfundimit të rrugës transit (përkaj së cilës do të shtrihet linja e re 10/20 kV), Komuna e Gjakovës e merr për obligim që pjesën e linjës e cila nuk përputhet me Pëlqimet e KEDS

nr 9556 dt 24.11.2020 dhe 5609 dt 24.07.2020, pas ndërtimit të rrugës, të rindërtojë dhe dislokojë ashtu siç e kërkojnë normat teknike minimale të KEDS.

Neni 2

Obligimet e Komunës së Gjakovës dhe Ngrohtores së Qytetit Gjakova

- 2.1 Komuna e Gjakovës është e obliguar të pajisë Ngrohtoren e Qytetit Gjakova me leje ndërtimi për projektin e përcaktuar në Nenin 1 të këtij MiM.
- 2.2 Ngrohtorja e Qytetit Gjakova është e obliguar, si ekzekutuese e projektit, të implementojë përkohësisht kanalin e kabullit dhe rrjetit të elektricitetit, duke ia përshtatur kushteve ekzistuese të terrenit, në përputhje me Pëlqimin Elektroenergjetik nr. 5609 të datës 24.07.2020 dhe 9556 dt. 24.11.2020 dhe ne baze të projektit të aprovuar nr. 20HA-08/062
- 2.3 Komuna e Gjakovës është e obliguar që, pas përfundimit të punëve në rrugë, të implementojë kanalin e kabllave në përputhje me Pëlqimin Elektroenergjetik nr. 5609 të datës 24.08.2020 dhe 9556 dt. 24.11.2020 dhe projektin e miratuar, me vulën e aprovimit nr. 20HA-08/063, të datës 26.11.2020. Implementimi i rrjetit dhe kanalit të përhershëm në përputhje me projektin e aprovuar, me vulën e aprovimit nr. 20HA-08/063 të datës 26.11.2020, duhet të bëhet në një periudhë prej deri në dy (2) vite duke nisur nga data e nënshkrimit të këtij MiM. **Nëse pas kësaj periudhe,- Komuna e Gjakovës nuk i përmbush obligimet e veta, KEDS ka të drejtë të shkyç objektet nga rrjeti elektrik pa njoftim/vërejtje paraprake.**

Neni 3

Obligimet e KEDS

- 3.1. KEDS është i obliguar që të energjizojë përkohësisht pjesën e linjës 10(20)kV në përputhje me standardet teknike, ndryshimin e konfigurimit në përputhje me Nenin 2, asfaltimin e rrugës, në përputhje me Pëlqimin Elektro-Energjetik nr. 5609 të datës 24.07.2020 dhe nr. 9556 dt. 24.11.2020 dhe projektit të aprovuar nr. 20HA-08/062.
- 3.2. KEDS është i obliguar të bëjë pranimin teknik të përhershëm të linjës, në momentin që Komuna e Gjakovës implementon kanalin e rrjetit dhe kabllave në përputhje me projektin e miratuar me vulën e aprovimit nr. 20HA-08/063 të datës 26.11.2020.

Neni 4

Dispozita të Veçanta

- 4.1 Ky **Memorandumi i Mirëkuptimit** hyn në fuqi pas nënshkrimit nga personat e autorizuar të palëve të autorizuara dhe pas regjistrimit në protokollet zyrtare të palëve; përderisa plotësimi/ndryshimi i këtij MiM mund të bëhet në çdo kohë me pëlqimin e palëve.

- 4.2 Për çfarëdo dëmsh eventuale (përfshirë ndaj palëve të treta) të shkaktuara si pasojë e dhe përfshirë vetë linjën 10/20 KV, të ndërtuar nga Ngrohtorja e Qytetit Gjakova, KEDS do të lirohet nga të gjitha dhe çfarëdo përgjegjësish. Kjo linjë, në vijim të ndërtimit të saj nga Ngrohtorja e Qytetit Gjakova, do të mbetet gjithashtu nën menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Ngrohtores së Qytetit Gjakova dhe kjo e fundit do të jetë përgjegjëse për të gjitha dhe çfarëdo pretendimesh në lidhje me këtë linjë.

Neni 5

Zbatueshmëria e Dispozitave Ligjore

Për çështje që nuk janë paraparë me këtë MiM, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike si ligj i zbatueshëm, si dhe rregulloret dhe procedurat e miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji ("ZRRE").

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Ky MiM është draftuar në bazën e kornizës ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës e cila rregullon qëllimin e këtij MiM, dhe në rast të mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë MiM, palët pajtohen të adresojnë çështjen tek ZRRE, përkatësisht Në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Neni 7

Kopjet e MiM

Ky MiM është draftuar në gjashtë (6) kopje origjinale, nga të cilat dy (2) iu dërgohen palëve, përderisa palët, si shenjë pranimi të të drejtave dhe detyrimeve nga ky MiM, nënshkruajnë të njëjtin pa vërejtje.

Kryetari i Komunës së Gjakovës



Ardian GJINI



Drejtori për investime në KEDS



Hasan ÖZ

U.D Kryeshefe Ekzekutive në N.P ngrohtorja e Qytetit Gjakova



Albana Skivjani

